



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1503/₁ prot.

Tiranë më 22.12.2017

REKOMANDIM

Nr. 46, datë 22.12.2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Në zbatim të Urdhrave nr.254, 255, 256, 257, 258 datë 12.10.2017, nr. 266, 267, 268, 269 datë 18.10.2017, nr. 272, 273, 274, 275 datë 25.10.2017, nr. 276, 277, 278, 279, 280, 281 datë 27.10.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë 19 nga 23 Institucione të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), institucione varësie të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (D.P.B.) me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të I.E.V.P.-ve Elbasan, Kavajë, Fier, I.V.Sh.B, Ali Demi, Jordan Misja, Mine Peza, Vaqarr, Durrës, Peqin, Burrel, Kukës, Krujë, Fushë-Krujë, Korçë, Lezhë, Vlorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë.

Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale janë institucione varësie të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat garantojnë masat e sigurisë, realizimin e trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, zbatojnë programet e rehabilitimit dhe rinteprimit, zbatojnë politikat shëndetësore si dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Drejtoria e Hetimit Administrativ, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e I.E.V.P.-ve, të cilët ishin njohur me Urdhrat e Komisionerit për kryerjen e hetimeve administrative.

Nga inspektimet e ushtruara dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga përfaqësuesit e I.E.V.P.-ve të kontrolluara, është konstatuar:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si organ epror, ka kryer "Njoftimin" pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që kryhen në zyrat qendrore dhe në institucionet e varësisë (I.E.V.P.), në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Në dosjet e personelit civil dhe të punonjësve të policisë së burgut konstatohet se ka dokumenta të tepërta referuar nenit 17 të Ligjit nr. 10032 datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", nenit 27 të Rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve" miratuar me Urdhrin nr.3125/1 datë 04.09.2009 të Ministrisë të Drejtësisë. Dokumenta të tepërta janë: Deklaratë e depolitizimit, informacione mbi gjendjen moralo-politike të individit, dokument me të dhëna "sensitive" të nëpunësit "Çertifikata shëndetësore për punonjësit" e detajuar (me të dhëna të tilla si grup gjaku, kqyrje fizike, ekzaminime laboratorike etj), masa disiplinore përtej afatit të parashikuar në nenin 70 pika 5 të Rregullores.
Konstatimi përbën shkelje administrative të Kreut II (Përpunimi i të dhënave personale) të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Në dosjet e personelit të disa prej I.E.V.P.-ve, është konstatuar ekzistenca e formularit: "Fleta Prezantuese e Dosjes Teknike të Nëpunësit Civil dhe Anketa Personale". Ky dokument është dërguar nga D.P.B nëpërmjet postës elektronike (e-Mail) drejtuar gjithë I.E.V.P.-ve. Formularët e plotësuar (dhe në proces) përmbajnë kategori të dhënash personale për punonjësit e Institucionit, tepër të detajuara (ekzaminime mjekësore, karakteristika fizike si grupi i gjakut, ngjyra e syve, referime për kredi të marra etj.), lidhjet me jashtë, referimet për kreditin, masat disiplinore, përdorimi i alkoolit, drogës dhe shëndeti mendor etj. Formularët aplikohen për të gjithë punëmarrësit me status civil dhe policor. Në rubrikën 20 të "Anketës Personale" perfrazohet: "Deklaroj se të dhënat e mia personale janë dhënë me pëlqimin tim, në zbatim të kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale...". Sa më sipër konkludohet se:
 - i. Për shkak të natyrës së funksionimit, kontrolluesi mund të përpunojë të dhëna personale nëse ato janë thelbësore për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të tij, megjithatë në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private.
 - ii. Zyra e Komisionerit e konsideron të tepërt plotësimin e anketës në mënyrë kaq të hollësishme dhe konkludon se kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimet ligjore të parashikuar në nenin 27 të Rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve" miratuar me

Urdhrin nr.3125/1 datë 4.9.2009 të Ministrit të Drejtësisë, nenin 5 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24 të Komisionerit datë 27.12.2012 "*Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhëna personale*".

- iii. Referuar nenit 3 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar "*Pëlqim i subjekteve të të dhënave*" është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij.

Në rastin konkret, dhënia e pëlqimit nuk mund të jetë në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*". Zyra e Komisionerit konkludon se, subjektet e të dhënave "*punëmarrës*" me status civil dhe policor nuk e kanë dhënë pëlqimin për arsye se plotësimi i "*Anketës Personale*" është kryer në mënyrë jo vullnetare. Dhënia e pëlqimit konsiderohet si e tillë në rastin kur subjekti i të dhënave ka mundësinë dhe të drejtën e refuzimit të deklaramit të të dhënave. Përpunimi i të dhënave personale në mënyrë të ligjshme (sipas dispozitave të Kreut të Dytë të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008) është detyrim ligjor i kontrolluesit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të dispozitave të Kreut të Dytë të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

4. Në dosjet e personelit policor dhe civil konstatohen dokumente me titull "*Vërtetim personaliteti*" bazuar në urdhrin nr. 6325 datë 10.08.2016 të D.P.B-së (Për plotësimin e dosjes individuale të punonjësve të policisë së burgjeve me dokumentin "*Vërtetim Personaliteti*"), në përmbajtje të të cilit ka informacione të lëshuar nga shefi i seksioneve për Hetimin e Krimeve të Drejtorisë së Policisë, në lidhje me shtetasit aplikant për punë, dokument në të cilin përshkruhet kontrolli mbi afërsinë dhe përbërjen familjare deri tek të afërmit e shkallës së parë dhe të dytë. Zyra e Komisionerit e konsideron të tepërt dhe jo në përmbushje të qëllimit për përpunimin e tyre, mbledhjen e të dhënave që përmban "*Vërtetimi i personalitetit*" për të afërmit e shkallës së parë dhe të dytë si dhe miqtë e afërm të familjes.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 5/c të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

5. Nga verifikimi i ambienteve në të cilat I.E.V.P.-të ushtrojnë aktivitetin si hyrjet, ambienti i vizitorëve, korridoret e administratës etj., është konstatuar se ato janë të mbikëqyrura nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Gjatë verifikimit në vend, është konstatuar se disponohen rregullore, udhëzime dhe procedura të mirëfillta për sistemet e video-vëzhgimit (CCTV) pavarësisht se të dhënat "*imazhe-video*" nuk trajtohen në kuadër të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Nga hetimet administrative të ushtruara, Zyra e Komisionerit ka konstatuar se pothuajse të gjitha I.E.V.P.-të nuk informojnë subjektet e të dhënave "*vizitorë*" dhe

“punëmarrës”, mbi përpunimin e të dhënave personale “imazhe-video” nëpërmjet sistemit të Video-Vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre.

Zyra e Komisionerit ka miratuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 *“Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* modelin standard të tabelës informuese, duke ju vënë në dispozicion kontrolluesve një mekanizëm standard për t’ju mundësuar subjekteve të të dhënave informimin mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit CCTV si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste çënimi.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit: *“Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.”.*

6. Disa prej subjekteve të kontrolluara dispononin Rregulloren *“Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale”* miratuar me Urdhrin nr. 496 datë 28.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve megjithatë, është konstatuar se ajo nuk është zbatuar nga nëpunësit e Institucioneve respektive.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar: *“2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera.”.*

7. Punonjësit e administratës të I.E.V.P.-ve, nuk përdorin sisteme të sigurta të postës elektronike e-Mail, por përdorin shërbime të jashtme si personeli.ievp@gmail.com. Përdorimi i sistemeve të jashtme për komunikimin e postës elektronike e-Mail përbën rrezik potencial për përhapje të paligjshme të të dhënave nëpërmjet lidhjeve të përbashkëta dhe shpërndarjes që sistemi/aplikacioni www.google.com mundëson. Konstatohet se D.P.B disponon domainin www.dpbsh.gov.al si adresë zyrtare të institucionit gjithashtu disponon dhe postë elektronike info@dpbsh.gov.al. Duke marrë në konsideratë faktet e mësipërme, konkludohet se D.P.B. i ka mundësitë për të krijuar adresa të postës elektronike për punonjësit apo seksione specifike të I.E.P.V.-ve në mënyrë që komunikimi institucional të paraqesë siguri, integritet për mospërhapje të paligjshme të të dhënave dhe informacioneve.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar.

8. Në të gjitha I.E.V.P.-të nuk ka punonjës për administrimin e pajisjeve kompjuterike. Në disa I.E.V.P. është konstatuar se pajisjet kompjuterike disponojnë sisteme operative Windows të palicensuar gjë e cila çënon sigurinë e sistemit/eve dhe të dhënave të regjistruara /përpunuara në kompjuter/a. Gjithashtu, në rast incidentesh nga shkëputja e

energjisë elektrike, pajisjet kompjuterike mund të dëmtohen dhe informacioni i përpunuar në to ka rrezik të madh për tu humbur dhe mos u rikuperuar sërish (duke marrë në konsideratë edhe faktin se pranë institucioneve të I.E.V.P. nuk realizohen procedura "Backup" për ruajtjen e të dhënave). Rezulton se disa I.E.V.P. nuk disponojnë masa shtesë për garantimin e elektricitetit në raste të mungesës së saj nga rrjeti dhe në ato institucione të cilat disponojnë pajisjet invertera (të cilat ndodhen në sallën e serverave), ato nuk garantojnë pavarësi të mjaftueshme elektrike nga rrjeti i jashtëm.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

9. Nga verifikimi i dokumentacionit personal të punësimit të personelit civil dhe policor, është konstatuar se të gjitha I.E.V.P.-të e kontrolluara nuk kanë marrë masa për "ruajtjen e konfidencialitetit" nga punëmarrësit të cilët, për shkak të detyrës dhe përshkrimit të pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit ka miratuar nëpërmjet Vendimit nr. 6 datë 05.08.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale" modelin standard të "Deklaratës së Konfidencialitetit", duke u mundësuar kontrolluesve një mekanizëm për të angazhuar nëpunësit në "ruajtjen e konfidencialitetit" në lidhje me të dhënat që ata aksesojnë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar: "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj".

Konstatimet e mësipërme në tërësinë e tyre përbëjnë tejkalim të mbledhjes së informacionit të kërkuar në zbatim të Ligjit nr. 10 032/2008 "Për policinë e burgjeve", Rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve" miratuar me Urdhrin nr.3125/I datë 4.9.2009 të Ministrit të Drejtësisë. Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24 të Komisionerit datë 27.12.2012 "Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhëna personale".

Në përfundim të hetimeve administrative të ushturara, janë mbajtur procesverbalet për çdo I.E.V.P. referuar Urdhërit përkatës të Kontrollit dhe një kopje e tij, i është lënë Institucionit të kontrolluar.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe në respektim të së drejtës për tu dëgjuar sa i përket shkeljeve të konstatuara, Zyra e Komisionerit, ka organizuar një seancë dëgjimore në të cilën janë ftuar të gjitha I.E.V.P.-të e kontrolluara si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si organ epror.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit mban në konsideratë faktin që të gjitha I.E.V.P.-të, kanë qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontroleve.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6, 7, 18, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të nenit 5, 6, dhe 7 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të përditësojë ku është e nevojshme dhe ti rikthejë subjekteve të të dhënave "*punëmarrës*" dokumentat e tepërta të cilat ndodhen në dosjet personale të tyre, në mënyrë që përmbajtja e dosjeve të jetë në përputhje me parashikimet në nenin 17 të Ligjit nr. 10032 datë 11.12.2008 "*Për Policinë e Burgjeve*" dhe nenit 27 të Rregullores "*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve*" miratuar me Urdhrin nr.3125/1 datë 04.09.2009 të Ministrit të Drejtësisë.
2. Kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të ndalojë procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale për subjektet "*punëmarrës*" nëpërmjet formularit: "*Fleta Prezantuese e Dosjes Teknike të Nëpunësit Civil dhe Anketa Personale*" si dhe të shkatërrojë të dhënat personale të tepërta, brenda periudhës 30 ditore nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.
3. Kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të standartizojë tabelat informuese për subjektet e të dhënave në lidhje me informimin mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste çënimi, sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri nëpërmjet Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*";
4. Kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar të marrë masa të përshtatshme për zbatimin nga të gjithë institucionet e varësisë (I.E.V.P.-të) të Rregullores "*Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale*" miratuar me Urdhrin nr. 496 datë 28.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve;
5. Kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të marrë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, për të krijuar adresa zyrtare të postës elektronike nën domainin www.dpbsh.gov.al, për punonjësit apo seksione specifike të I.E.P.V.-ve,

- në mënyrë që komunikimi institucional të paraqesë siguri, integritet, kontroll dhe mospërhapje të paligjshme të të dhënave dhe informacioneve.
6. Kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar të marrë masa të përshtatshme për të garantuar sigurinë, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave elektronike, pajisjeve kompjuterike, sistemeve operative, sistemeve video-vëzhguese (CCTV) etj.
 7. Kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masa për ruajtjen e konfidencialitetit nëpërmjet nënshkrimit të "Deklaratës së Konfidencialitetit" nga punëmarrësit të cilët, për shkak të detyrës dhe përshtimit të pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
 8. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të kryejë plotësimin e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim brenda afatit 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni, dhe të njoftojë me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për masat e marra. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
 9. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 22/12/2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

